

STATUT

I shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

"GSA Energy" Shpk

Miraturar në datën 27.05.2025.

Në këtë statut

- "Ligji" është legjislacioni Shqiptar në fuqi dhe në veçanti Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare",
- "Statuti" është ky Statut i shoqërisë;
- "Shoqëri" është Shoqëria "GSA Energy" SHPK

Kreu I Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1 - Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin "GSA Energy" SH.P.K. themelohet sot në datën 27.05.2025 nga ortakut i vetëm si më poshtë:

Shoqëria "GSA" shpk me NUIS J61820031J e cila zotëron 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë e cila përfaqësohet nga Administratorët Z. Serafin Orgocka dhe Z. Agron Shaplo.

Neni 2 - Objekti

- 2.1 Shoqëria "GSA Energy" shpk themelohet nga ortakut "GSA" shpk në kuadër të strukturimit të aktiviteteve ekonomike që kryhen nga ky ortak duke e veçuar aktivitetin në fushën e Energjisë nga aktivitetet e tjera ekonomike.
- 2.2 Shoqëria "GSA Energy" do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
 1. Import - Eksport, Tregtim dhe Furnizim me shumicë dhe pakicë të:
 - i. Energjisë elektrike.
 - ii. Gazit Natyror.
 - iii. Pajisje Elektrike dhe Aparatura Elektronike.
 - iv. Produkte, mallra dhe lëndë të para të përdorimit industrial dhe të përgjithshëm.
 - v. Makineri, pajisje për përdorim industrial dhe të përgjithshëm dhe mjete informatike.
 2. Aktivitete Konsulente dhe Projektimi Inxhinjrik.
 3. Ndërtimin, prishjen, rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike, ndërtimin e nënstacioneve, kabinat e transformatoreve, linjave të tensionit të ulët, të mesëm e të lartë dhe shpërndarjes të energjisë, si dhe çdo ndërtim tjetër.
 4. Aktivitet në fushën e ndërtimit të struktura civile dhe industriale.
 5. Çdo aktivitet tjetër që perputhet me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe që konsiderohet nga shoqëria me përfitim dhe i dobishëm për arritjen e objektivave të saj.
- 2.3 Objekti mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 3 - Kohëzgjatja



Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

Neni 4 - Selia – Stema - Logo

- 4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Ibrahim Rugova, Pallati nr.64, Tiranë.
- 4.2 Selia mund të ndryshohet me vendim me shumicë të thjeshtë të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- 4.3 Shoqëria ka stemën (logon) e saj e cila përbëhet nga të dhënat e saj (sipas rastit adresa e selisë, NUIS-i apo informacione të tjera) dhe emrin e saj. Stema (logo) përfundimtare e shoqërisë dhe vula e saj do të propozohet nga administratori dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve pas regjistrimit të shoqërisë. Logo do të përdoret në dokumentet zyrtare të shoqërisë.
- 4.4 Shoqëria ka vulën e saj. Vula krijohet në aq ekzemplarë sa ka administratorë. Në rast se janë disa administratorë atëherë secili Administrator mban dhe përdorë vulën e tij.

Kreu II Kapitali

Neni 5 - Kapitali themeltar


- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është në vlerën e 1.000.000 (një milion) Lekë.
- 5.2 Kapitali themeltar shlyhet plotësisht dhe zotërohet plotësisht nga ortaku i vetëm shoqëria "GSA" shpk me NUIS J61820031J e cila zotëron 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë dhe për pasojë është pronare e një kuotë të vetme të barabartë me 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë:

Neni 6 - Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 6.1 Me vendim me shumicë të cilësuar të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, kapitali i shoqërisë mund të zvogëlohet ose të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.
- 6.2 Në rast të rritjes së kapitalit me anë të kontributeve në natyrë ortaku/ët do t'i komunikojnë me shkrim Administratorit kategorinë e sendeve që do t'i kalohen në pronësi shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një ekspert të jashtëm të pavarur për të përgatitur një raport ku të figurojnë të listuara qartësisht sendet objekt kontributi dhe vlera përkatëse në para e secilit prej tyre. Raporti i mësipërm do t'i paraqitet ortakut/ëve brenda një kohe të arsyeshme për t'u njohur dhe komentuar mbi të. Komentet e ortakut/ëve, nëse ka, i transmetohen menjëherë ekspertit nga administratori. Pas ezaurimit të komenteve, eksperti përgatit raportin final i cili i kalohet për votim Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve që e miraton me një shumicë prej $\frac{3}{4}$ të ortakëve.
- 6.3 **Zmadhimi i kontrolluar i kapitalit me anë të futjes së një ortaku të ri:** Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me shumicë prej $\frac{3}{4}$ të ortakëve mund të vendosë që kapitali i shoqërisë të rritet me një vlerë të caktuar ose deri në një vlerë të caktuar brenda një afati të caktuar. Kjo rritje mund të bëhet vetëm me anë të kontributit financiar në të holla përveç nëse Asambleja vendos ndryshe në unanimitet.
Në këtë rast, secili nga ortakët e shoqërisë ka të drejtë të kontribuojë në rritjen e kapitalit me një vlerë të barabartë me kuotën që ai zotëron në momentin e vendimit. Ortaku që zgjedh të mos kontribuojë në këtë zmadhim kapitali mund të pësojë një zvogëlim të përqindjes së kuotës së tij në rast se ortakët e tjerë do të zgjedhin të kontribuojnë në masën e tyre.
Gjithashtu, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë në të njëjtin vendim dhe me një shumicë prej $\frac{3}{4}$ të ortakëve që kapitali të rritet me anë të kontributit të një pale të tretë e cila në këtë rast do të bëhet ortakë në shoqëri në përqindjen dhe masën e përcaktuar në vendim. Në rast se Asambleja ka vendosur që vlera që do të pagohet nga ortaku i ri është më e madhe sesa kuota që do të zotërojë ky ortak i ri në kapitalin themeltar të shoqërisë atëherë diferenca (kuptuar si vlera e paguar nga ortaku i ri – përqindja që do të zotërojë ky ortak i ri në kapitalin themeltar të shoqërisë) do të trajtohet si "Prim emetimi".

Neni 7 - Transferimi i kuotave të kapitalit

- 7.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) shitblerjes;



- b) trashëgimisë;
 - c) dhurimit;
 - ç) Dhënies si kontribut në kapitalin e një shoqërie tjetër;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.2 Ortaku që dëshiron të shesë kuotat e tij detyrohet më parë t'ia ofrojë këto kuota ortakëve të shoqërisë në të njëjtat kushte.

Kreu III Organet Vendimmarrëse Dhe Drejtuese

Neni 8 - Organizimi i Shoqërisë

- 8.1 Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:
- 1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve që është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
 - 2. Administratori i shoqërisë.
- 8.2 Shoqëria organizohet në Drejtori dhe Departamentet sipas rastit.

Neni 9 - Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme vendos për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
 - ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) ndryshimin e selisë së shoqërisë;
 - j) marrjen e një huaje në vlerë mbi 100.000.000 (njëqind milionë) lekë nga ortakët;
 - k) marrjen e një kredie apo huaje nga një institucion financiar;
 - l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 10 - Administrimi

- 10.1 Shoqëria do të administrohet nga 1 (një) administrator.
- 10.2 Administratori i parë i shoqërisë do të jetë Z. Agron Shaplllo, i datëlindjes 20/04/1953, me numër personal F30420145K, i cili emërohet për një mandat që fillon në datën 27.05.2025 dhe përfundon në datën 26.05.2030.
- 10.3 Administrator mund të jetë çdo person që përzgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- 10.4 Administratori në raport me palët e treta mund të përdor titullin "Administrator" ose në anglisht "Chief Executive Officer".
- 10.5 Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme në vendimin e emërimit së bashku me momentin e fillimit të tij dhe mbarimit të tij. Megjithatë, në rast se Asambleja e Përgjithshme e lë në heshtje, kohëzgjatja e mandatit të administratorit është parimisht 5 (pesë) vjet dhe fillon në datën e vendimit të Asamblesë dhe mbaron 5 (pesë) vjet më pas.
- 10.6 Mandati i Administratorit mund të ripërtërihet në mënyrë të pakufizuar.



- 10.7 Administratori shkarkohet dhe/ose emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me një shumicë prej 51% të votave. Administratori mund të shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme në mënyrë ad nutum, lirisht pa pasur nevojë që të përcaktojë një shkak, njoftojë paraprakisht apo ndjekë ndonjë procedurë specifike.
- 10.8 Për ushtrimin e funksioneve të tij Administratori do të nënshkruaj një Kontratë Administrimi me shoqërinë në të cilën do të përcaktohen elementët e marrëdhënies mes palëve si paga, shpërblimet, oraret etj... Kontrata e Administrimit si rregull negociohet dhe nënshkruhet për llogari të shoqërisë nga përfaqësuesi i ortakut që zotëron shumicën e kapitalit themeltar të shoqërisë në momentin e bërjes së saj dhe më pas kalohet për miratim nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve në aktin e emërimit të Administratorit përkatës. Kontrata e Administrimit hyn në fuqi vetëm nëse miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me shumicë të thjeshtë të të gjithë ortakëve.

Neni 11 - Kompetencat e Administratorit

11.1 Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- ka të gjitha kompetencat për të vepruar me të tretët në emër të shoqërisë dhe në interes të saj në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe Statuti i shoqërisë ia njeh shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme.
- përfaqësojë shoqërinë tregtare në raport me të tretët dhe pranë organeve shtetërore;
- kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- mund të delegojë me anë të prokurës tek të tretët brenda kufijve që ligji e lejon dhe në kufijtë që e lejon Statuti dhe/ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve për kategori të caktuara veprimesh;
- raportoje përpara ortakut në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

Neni 12 - Përgjegjësia e Administratorit


12.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkeljen prej tij të ligjeve, për shkeljen prej tij të statutit, apo për faje të kryera prej tij gjatë administrimit të shoqërisë.

Megjithatë, në referim të parashikimit të mësipërm të këtij paragrafi, Administratori nuk është përgjegjës për veprimet apo shkeljet e kryera nga punonjësit e shoqërisë dhe/ose strukturat dhe/ose përgjegjësit e saj.

12.2 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi;
- të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

12.3 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 12.1 dhe 12.2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.



12.4 Administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe/ose Statutin e Shoqërisë kryen veprimet e mëposhtme:

- a) i kthen ortakut kontributet;
- b) u shpërndan ortakut/ëve aktivet shoqërisë;

Kreu IV Viti financiar - ekspertët

Neni 13 - Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 14 - Ekspertët

14.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

14.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar.

Kreu V Prishja – riorganizimi i shoqërisë

Neni 15 - Prishja dhe likuidimi

15.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohe :

- a. me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- b. me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d. me vendim të gjykatës;

15.2 Në këtë rast Ortaku merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri në likuidim e sipër".

15.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

15.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku.

Neni 16 - Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja


Shoqëria mund të ndahet, bashkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 17 - Baza Ligjore

17.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

17.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 18 - Mosmarrëveshjet






Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 19 - Dispozita të fundit

Ky Statut përbëhet nga 6 faqe dhe 19 nene dhe nënshkruhet në fund nga përfaqësuesi i Ortakut të vetëm të shoqërisë.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË "GSA Energy" SHPK:

Shoqëria GSA shpk përfaqësuar nga Administratorët	
Z. Serafin Orgocka 	Z. Agron Shaplllo 
 (Emër, Mbiemër, firma, vulë e shoqërisë "GSA" shpk)	
Vendi:	Tiranë, Shqipëri